



Financuar nga
Bashkimi Evropian


center for
transparency
and freedom of
information

ema
EUROPEAN MOVEMENT ALBANIA

Raport

2025

RAPORT MONITORIMI, GJYKATA E LARTË, 2024



PUBLIKUES

QENDRA PËR TRANSPARENÇË DHE INFORMIM
TË LIRË (CTFI)

Adresa: Rr. Komuna e Parisit, Pal.2, Sh. 2,
Tirana, Albania

Tel: +355 682088602

E-mail: info@transparence.al

Web: www.transparence.al

VITI I PUBLIKIMIT:

2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE” , me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Hyrje	03
Organigrama	04
Buxheti	05
Ndërtesa e re e Gjykatës së Lartë drejt zgjidhjes	08
Kosto për çështje	10
Stoku	10
Adresimi i stokut	13
Prokurimet	14
Transparenca	15
Gjetje dhe përfundime	15
Rekomandime	17
Bibliografia	18

Hyrje

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë qëndron në majën e piramidës gjyqësore ndërsa baza ligjore e saj është Kushtetuta e Shqipërisë, ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligje të tjera që rregullojnë funksionimin e saj.

Gjykata e Lartë shqyrton rekurset kundër vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e posaçme të shkallëve më të ulëta ndërsa i ushtron funksionet gjyqësore përmes kolegjeve të saj: Kolegji Civil, i cili shqyrton rekurset kundër vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, si dhe për çështje të tjera, të përcaktuara në ligj; Kolegji Penal, i cili shqyrton rekurset kundër vendimeve penale të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe nga gjykatat e posaçme për çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe për çështje të tjera, të përcaktuara në ligj; Kolegji Administrativ, i cili shqyrton rekurset kundër vendimeve të gjykatave administrative.

Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.

Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur, Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit ndërkohë një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

Bazuar në këtë standard, një nga risitë e reformës në drejtësi të vitit 2016 ishte dhe kompetenca që 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të zgjidhen nga Gjykata e Lartë.

Organigrama

Organika e Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Lartë për vitin 2024 është 17-18 gjyqtarë. Trupa është e ndarë në 3 kolegje, Kolegji Administrativ 6 gjyqtarë, Kolegji Civil 7 gjyqtarë, Kolegji Penal 5 gjyqtarë. Në vendimin nr.1, të janarit 2021, të Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, upërcaktua se organika e Njesisë së Shërbimit Ligjor përbëhet nga 32 këshilltarë ligjorë [1].

Me një tjetër vendim, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rritjen e numrit të Njesisë së Shërbimit Ligjor në 38 (nga 32) [2]. Në vitin 2024, pranë Gjykatës së Lartë u komanduan 66 këshilltarë të rinj (ndihmës magjistratë), por ndërkohë 5 këshilltarë ligjorë u larguan, 37 ndihmësmagjistratë për shkak të mbarimit të mandatit të komandimit, 1 këshilltar ligjor për shkak të daljes në pension dhe 1 këshilltar ligjor u pezullua me vendim të KPK.

Më poshtë është tabela e stafit aktiv të Gjykatës së Lartë për vitin 2024 përkundrejt stafit në organikë.

nr. i gjyqtarëve aktivë	nr. i gjyqtarëve në organikë	nr. i stafit mbështetës në organikë	nr. i stafit mbështetës në fakt	fakti / organikë në %	staf për gjyqtar sipas organikës	staf për gjyqtar sipas faktit
17	19	129	110	85%	6.8	7.6

Kancelari në Gjykatën e Lartë vijon ende të jetë i komanduar në këtë detyrë.

Gjykata e Lartë ka kërkuar edhe shtimin e numrit të gjykatësve nga 19 në 25. Kërkesa për shtesë lidhet me rritjen e punës në gjykatat e Apelit që deri tani kanë akumuluar një numër të madh stoku [1]. Praktikisht nevojat për personel janë plotësuar në mënyrë të kënaqshme. Gjykata e lartë kishte 131 punonjës në vitin 2020 ndërsa në 2025 ka 151 punonjës.

[1] Vendimi nr.1, 21.01.2021 i Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë”
[2] Vendimi nr.1, 1209.2024 i Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë”
[3] Ida Vodica, takim në KLGJ, 22 korrik 2025

Buxheti

Fondi i vënë në dispozicion të Gjykatës së Lartë për 2024 është 392,341 mijë lekë, ose afro 4 milionë euro. Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Gjykatës së Lartë si dhe realizimi i tyre është 386297 mijë lekë, ose 98%, pra një mosrealizim – 6044 mije lekë në raport me planin e parashikuar. Ndërsa fondi për Gjykatën e Lartë sipas një vendimi të KLGJ në dhjetor 2023 ishte parashikuar në shumën 401,120,000 lekë [4] ose pak më shumë se 4 milionë euro.

Shpenzime për honorare për anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) gjatë vitit 2024 janë në shumën 3.485.000 lekë.

Gjykata e Lartë nuk ka pasë probleme me furnizimin me buxhet për vitin 2024 si dhe janë plotësuar kërkesat buxhetore për vitin 2025. Në vitin në vijim u morën parasysh 100% kërkesat e gjykatës së Lartë për buxhet. Gjithë kërkesa për buxhet është mbështetur nga ana e KLGJ, ndërsa ndryshimet në buxhet nuk kanë sjellë probleme në zbatimin e detyrave të gjykatës [5].

Në lidhje me pagat në nivele të ndryshme të gjyqtarëve të gjykatës së Lartë, gjykatësit e hodhën në gjyq çështjen e pagës në gjykatën administrative dhe ata e fituan gjyqin . Kështu që pagesa do të vijoje të kryhet ashtu si edhe më parë [6].

Frekuenca e buxhetit për Gjykatën e Lartë në vitet 2015-2024:

Buxheti në vitin 2015 ishte 188,216,000, u realizuar në masën 99,8%. Për vitin 2016 buxheti ishte 175,652,000, u realizuar në masën 99,7%. Për vitin 2019 buxheti ishte 177,000,000 lekë por u realizua vetëm në shumën 101,767, 000 lekë; për vitin 2020 ishte: 155,553,000 lekë por u realizua në shumën 122,946,393 lekë. Për vitin 2021 ishte 263,760,000 lekë. Fondi i vënë në dispozicion të Gjykatës së Lartepër vitin 2022 është në shumën 280,711,000 leke. Buxheti i realizuar në këtë vit është 269,450,000 lekë.


[4] Vendim i KLGJ, nr. 743, datë 28.12.2023 për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për sistemin gjyqësor

[5] Filloreta Ajdini, përgjegjëse e buxhetit në GJL, takim me 22 korrik 2025

[6] Po aty.

Buxheti i Gjykatës së Lartë 2015-2024 në lekë

Viti	Buxheti	Realizimi	% e realizimit
2015	188,216,000	I plotë	99,8%
2016	175,652,000	I plotë	99,7%
2019	177,000,000	101,767, 000	57,5%
2020	155,553,000	122,946,393	79%
2021	263,760,000		
2022	280,711,000	269,450,000	95,9%
2023	382,566,000	374,519,000	97,9%
2024	392,341,000	386,297,000	98%



Art. 600 ka shpenzuar më pak në shumën - 262 mijë lekë dhe art. 601 në shumën -1119 mijë lekë për shkak të vakancave në organikë dhe kryesisht këshilltarë ligjorë. Në art.602 ka një diferencë mos realizimi në shumën prej - 3583 mijë lekë [7].

Tab. Buxheti i Gjykatës së Lartë në mijë lekë për vitin 2024, shpërndarja e tij

Art.	Emertimi	Buxheti viti 2024	
		Plani fillestar	Plani rishikuar gjate vitit
600	Paga	315400	297930
601	Sigurime Shogërore	35000	35000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	46000	58338
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	220	893
	<i>Shpenzime Korrente</i>	<i>396620</i>	<i>392161</i>
230	Kapitale të Patrupëzuar a		
231	Kapitale të Trupëzuara	4500	4500
	Shpenzime Kapitale	4500	4500
	<i>Shpenzime nga Të a Ardhurat</i>	60	60
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardhurat)	401180	396721

Në zërin shpenzime për mallra e shërbime, janë planifikuar dhe realizuar me procedurë prokurimi "Blerje me vlerë të vogël" në mënyrë elektronike si dhe me procedurë "me vlerë nën 100 mijë lekë": mirëmbajtje pajisjeve elektrike në shumën 516 mijë lekë, mirëmbajtje e pajisjeve teknike në shumën 818 mijë lekë, larje makinash 879 mijë lekë, mirëmbajtje ashensori 128 mijë lekë, blerje shtypshkrime 970 mijë lekë, blerje uniforma 213.6 mijë lekë, material pastrimi 561.4 mijë lekë, mirëmbajtje lulishte 99.5 mijë lekë, siguracion mjete transporti 1485.4 mijë lekë, mirëmbajtje godine 600 mijë lekë, blerje goma makine 468 mijë lekë, mirëmbajtje gjeneratori në shumën 184.8 mijë lekë, mirëmbajtje sistem sigurie në shumën 468 mijë lekë, shërbim dezinfektimi 117 mijë etj., për të cilat janë lidhur kontrata përkatëse me afat deri 31.12.2024.

Përsa i përket realizimit të shpenzimeve në zërat e tjerë në artikullin 602, janë realizuar shpenzimet për karburant në shumën 7526 mijë lekë, taksë qarkullimi automjete në shumën 521 mijë, pjesë këmbimi 2353 mijë lekë, për shërbim printimi në shumën 3136 mijë lekë. Shpenzimet për shërbime: energji elektrike 3067 mijë, ujë 140.7 mijë, telefon 2386 mijë, poste 2123.6 mijë etj., të cilat janë realizuar sipas planifikimit buxhetor. Po kështu janë realizuar shpenzimet për pritje, udhëtim e dieta, kuotizacion, etj. si vijon: Shpenzime për pritje 1016 mijë, shpenzime kuotizacioni 778 mijë, udhëtime e dieta 3650 mijë, shpenzime për ekzekutim vendime gjyqësore në shumën 15078 mijë lekë, shpenzime avokat kryesisht 82 mijë [8].

Për këtë vit janë vazhduar kontratat me procedurë “marrëveshje kuadër” si më poshtë: Mirëmbajtje mjete transporti, shërbim printimi: blerje karburanti.

Në artikullin 231 kapitale të trupëzuara janë planifikuar është kryer procedura për rikonstruksionin e godinës dhe është shpallur fitues operatori ekonomik. Është kryer procedura për “Blerje Pajisje” dhe është shpallur fitues operatori ekonomik. Realizimi për zërin “Blerje Pajisje” është në shumën 664.7 mijë lekë dhe në zërin “Rikonstruksion” është në shumën 2822 mijë lekë. Kontratat janë realizuar të plota.

Në lidhje me zërin e shpenzimeve ato janë rritur në sektorin e shërbimeve, veçanërisht është rritur kosto e mirëmbajtjes së faqes dhe ajo e serverit, për shkak të rritjes së përmbajtjes së depozituar në server, po ashtu edhe nevoja për mbrojtje nga sulmet kibernetike [9].

Ndërtesa e re e Gjykatës së Lartë drejt zgjidhjes

Gjykata e Lartë më në fund ka marrë lejen për ndërtim ose sheshin e ndërtimit dhe ndërtesa e re do të jetë pjesë e një marrëveshje me kompaninë e ndërtimit nga ana e qeverisë ku i ofrohet tokë publike në këmbim të ambienteve të gjykatës. Gjykata e Lartë ka sot 2362 metër katror sipërfaqe pune ndërkohë që në ndërtesën e re që pritet të përfundojë në vitin 2027 do të ketë afro 7000-8000 metra katror.

[8] Raporti vjetor i performancës, GJL 2024 f.60

[9] Filloreta Ajdini, përgjegjëse e buxhetit në GJL, takim me 22 korrik 2025

Procedura për dhënien përfundimtare të lejes së ndërtimit për kompleksin në Bulevardin e Ri të Tiranës, Blloku 4, të përbërë nga dy kulla private dhe ndërtesa e re e Gjykatës së Lartë, është drejt përfundimit[1].

Leja është dhënë nga KKRT e Republikës, dhe mbetet vetëm zbardhja e saj nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë. Kompania private ndërtuese e kompleksit që përfshin dy kullat private dhe ndërtesën e re publike të Gjykatës së Lartë, me pesë kate mbi tokë dhe dy kate nëntokë, ka bërë tre prezantime të projektit përpara drejtuesve të Gjykatës së Lartë.

Sipas prezantimeve, ndërtesa e re do të ketë një sipërfaqe totale prej 7,000 m². Projekti fillestar i kompanisë është kontestuar [11] nga drejtuesit e Gjykatës së Lartë, me qëllim që të bëhen më funksionale mjediset e reja në të pesë katet e ndërtesës. Kompania private paraqiti një projekt të përmirësuar, i cili i përshtatet më mirë nevojave të Gjykatës për mjedise funksionale.

Kontrata është lidhur me kushtin që kompania investuese të ndërtojë fillimisht ndërtesën publike të Gjykatës dhe më pas të dy kullat e saj. Ende nuk dihet vlera në lekë e ndërtesës së re, me sipërfaqe 7,000 m², të Gjykatës së Lartë.

Kontrata është një kontratë sipërmarrjeje. Bashkia e Tiranës vë në dispozicion truallin publik për ndërtuesin privat. Ky truall tjetërsohet dhe bashkia merr në këmbim ndërtesën e re të Gjykatës së Lartë, me sipërfaqe 7,000 m², pa shpenzime shtesë nga Buxheti i Shtetit.

Me nisjen e zbatimit të kontratës, regjistrimi në Kadastër si pronar i ndërtesës së re do të bëhet në emër të KLGJ-së. Kjo ka rëndësi, pasi nëse pronar do të figurojë bashkia, që po nënshkruan kontratën me kompaninë investuese, do të vështirësohet shumë marrja e lejeve për punime të mundshme rikonstruksioni të ndërtesës dhe mjediseve të saj nga ana e Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë, në këtë investim, ka për detyrë të realizojë projektin e mobilimit të ndërtesës së re me pajisjet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të saj. KLGJ do të lëvrojë fondin e duhur për këtë projekt mobilimi, sapo të nisë puna konkrete për ndërtimin e godinës.

Ende nuk dihet një afat i qartë (dy ose tre vjet, për shembull) për kohëzgjatjen e punimeve të ndërtimit të godinës së re, pasi të nisë ndërtimi [12].

[11] Po aty

[12],kancelare ne detyrë, takim në GJL , 22 korrik 2025

Kosto për çështje

Sasia faktike e 'çështjeve të gjykuara' në Gjykatën e Lartë për vitin 2024 është 7639 ndërsa shpenzimet korente mbi të cilën llogaritet kosto për njësi janë 382.810.000 lekë. Kosto për njësi është 50.000 lekë [13]. Shifra është afro 5 mijë lekë më shumë se viti 2023.

Edhe atë vit ka rritje të kostos krahasuar me vitin 2022, kjo si rezultat i rritjes së fondit të pagave për pagesën e diferencave të pagave të gjyqtarëve dhe të këshilltarëve gjyqësor.

Shpenzimet korente ku përfshihen pagat, sigurime dhe mallra e shërbime të tjera për vitin 2023 ishin në shumën 362,161,000 lekë ndërsa u shqyrtuan gjatë atij viti, 7914 çështje. Kosto për një çështje është 45,762 lekë.

Në vitin 2022 u shqyrtuan 6335 çështje. Ndërsa shpenzimet korente ishin 238,873,000 lekë. Kosto për një çështje ishte 37,706 lekë.

Por si ka qenë ky indikator në vitin 2021. Gjatë këtij viti shpenzimet korente ishin në vlerën 231,000,000 lekë ndërsa u gjykuan 3325 çështje. Kosto për çështje ishte 69,473 lekë, i cili mban edhe koston më të lartë në katër vitet e fundit.

Stoku

Në fund të vitit 2024, stoku (BT) i Gjykatës së Lartë ishte 20,058 çështje, duke shënuar një rënie prej 19.8% ose 5,170 çështje më pak, krahasuar me fillimin e vitit kur backlog-u ishte 26,058 çështje.

Gjykata e Lartë e ka filluar vitin 2024 me një backlog prej 26,058 çështjesh në pritje të gjykimit. Krahasuar me vitin e kaluar, stoku paraqet një ulje prej 18%.

[13] Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit 2024, GJL, aneksi 3


Nga analiza e shpërndarjes së stokut rezulton se: [14] 59% e backlog-ut i përket çështjeve civile; 29% e stokut i përket çështjeve administrative; 12% e backlog-ut i përket çështjeve çështje penale, përqindje kjo relativisht e ulët në krahasim me kategoritë e tjera.

Stoku i çështjeve gjyqësore të pashqyrtuara gjatë vitit 2023 BT ishte 26.058 çështje ndërsa u dhanë në total 7914 vendime gjyqësore.

Nga korriku 2020 kur u regjistrua dhe shifra më e lartë e stokut e deri në dhjetor 2023, sasia e tij ka rënë me 32%.

Tab: Situata e BT në vitet 2019-2021 në Gjykatën e Lartë

Viti	Stoku i çështjeve BT
2019	28657
2020	34520
2021	36066
2022	31827
2023	26058
2024	20058



Gjatë vitit 2024, në Gjykatën e Lartë janë regjistruar gjithsej 2,469 çështje të reja, duke shënuar një rritje prej 15% ose 324 çështje më shumë krahasuar me vitin 2023.

Shifrat e shpërndarjes së stokut përgjatë 2024 kanë një kakofoni në raportet e institucioneve gjyqësore, pasi në raportin e KLGJ ka disa shifra të tjera të cilat pavarësisht se nuk çënojnë trendin e shifrave ndyrhsojnë nga njëra tjetra, si në vijim. (Nga analiza e shpërndarjes së backlog-ut sipas natyrës së çështjeve, rezulton se ështëjet civile përbëjnë 64% të backlog, çështjet administrative përbëjnë 28% të backlog-ut, çështjet penale përbëjnë vetëm 8% të backlog-ut [15]).

Përqindjen më të madhe në volumin e çështjeve të prapambetura vijojnë ta zënë çështjet e regjistruara në vitin 2018, ndërkohë që çështjet me vit regjistrimi më të hershëm [16] janë në zbritje. Parashikohet se brenda 4 viteve Gjykata e Lartë mund të eliminojë stokun bazuar në ritmet e krijuara në vitin 2024.

Backlog në Gjykatën e Lartë filloi të krijohej që në vitin 2013 me afro 2% të çështjeve të mbetura stok për të vijuar me një rritje deri në 5% në vitin 2014 dhe për të vijuar me një rritje më të shpejtë në vitet në vijim. Ka çështje të regjistruara në Gjykatën e Lartë në vitin 2010 që mund të kenë marrë përgjigje në vitin 2023.

[15] Raporti vjetor i KLGJ, 2024, f.71

[16] <https://www.facebook.com/share/p/1CsQ7vvvTG/>

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (WR)[17]. Treguesi WR ka rënë me 23% të tij, konkretisht nga 2,084.2 çështje për gjyqtar në vitin 2023 në 1,602.6 çështje në vitin 2024. Numri i gjyqtarëve efektivë është rritur me 9.2%, nga 16.3 në vitin 2023 në 17.8 në vitin 2024, duke ndihmuar në shpërndarje më të barabartë të ngarkesës së punës.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (ER). Në vitin 2024, treguesi ER për Gjykatën e Lartë, pëson rënie me 11.6% duke arritur në 429.2 çështje për gjyqtar nga 485.5 çështje për gjyqtar që ishte në vitin 2023.

Norma e likuidimit të çështjeve penale (CR) ka shënuar një rënie nga 369% në 309% [18]. (Edhe në këtë rast ka problem me shifrat: sipas raportit të KLGJ CR është 275.8% nga 265.2% [19] në vitin 2023).

Koha për evadimin e çështjeve (DT) civile është ulur në 1690.4 ditë, nga 2087.7 ditë në vitin 2023.

Vendimet e mospranimit në dhomë këshillimi përbëjnë 73% të vendimmarrjes së përgjithshme të Gjykatës, ndërsa të ndara sipas natyrës së çështjeve ato zënë 70% në çështjet administrative, 68% në çështjet civile dhe 81% në çështjet penale.

Adresimi i stokut

Në korrik 2021, Gjykata e Lartë hartoi Planin e Veprimit për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura. Në vijim të miratimit të Memorandumit të Mirëkuptimit mes KLGJ dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), më pas mbështetur nga Departamenti i Shtetit, Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA në Shqipëri, Gjykata e Lartë është mbështetur me burime njerëzore, në funksion të reduktimit të numrit të çështjeve të prapambetura. 12 nëpunës për Uljen e Çështjeve të Prapambetura (NUNÇP), pas një procesi inventarizimi të rreth 29,000 çështjeve të prapambetura kreu kategorizimin e çështjeve në grupe prioritare.

[[17] Metodologjia CEPEJ e përkthyer në vendimin 47, datë 11.02.2021 të KLGJ-së, përpunon disa indikatorë apo tregues bazë të funksionimit të gjykatës, të tillë si: (i) Ngarkesën e punës në secilën gjykatë; (ii) Gjendjen e backlog-ut në gjykatë; (iii) Prurjet e çështjeve të reja në gjykatë; (iv) Ngarkesën mesatare të gjyqtarëve (Treguesi WR); (v) Normën e efikasitetit (Treguesi ER); (vi) Raportin e qarkullimit të çështjeve (Treguesi RQC); (vii) Kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes (Treguesi DT); (viii) Normën e zgjidhjes së çështjes (Treguesi CR); (ix), etj

[18] Raporti vjetor i performancës, GJL 2024 f.30

[19] Shpjegim: Në raportin vjetor të KLGJ për vitin 2023 CR për Gjykatën e Lartë është llogaritur 369%. Shifra e mësipërme është shkëputur nga raporti i KLGJ për vitin 2024. Ndërsa raporti i GJL për vitin 2024 vlerëson se CR është 309%

Deri më 31 dhjetor 2024, NUNÇP kanë përpunuar dhe përpiluar formularët përkatës të informacionit mbi 18,391 çështje civile, administrative dhe penale, nga të cilat 17,872 (pra, 97% e çështjeve të përpunuara) u janë caktuar këshilltarëve ligjorë për trajtim, gjatë periudhës prill 2021-dhjetor 2024. Gjithsej, bazuar në informacionin paraprak të përpunuar nga NUNÇP gjatë periudhës prill 2021-dhjetor 2024, Gjykata ka shqyrtuar 16,730 çështje (pra, 91% e çështjeve të përpunuara, ose 94% e çështjeve të dorëzuara pranë këshilltarëve ligjorë). Në tërësi që nga fillimi i mbështetjes NUNÇP kanë kontribuar në përpunimin paraprak të 78% të vendimmarrjes së gjykatës [20].

NUNÇP nuk e vazhdojnë më aktivitetin e tyre në Gjykatën e Lartë dhe ata nuk janë zëvendësuar. Kosto e tyre ka qenë 70 milionë lekë të reja në vit dhe nuk është paguar nga Gjykata e Lartë por nga projekti. Pritet që boshllëku i lënë prej tyre të plotësohet me numrin e këshilltarëve për gjykatës që është propozuar së paku 1 gjyqtar dhe 2 këshilltarë ligjorë si dhe një sekretare gjyqësore. Kjo do të thotë se gjykata ka nevojë për 38 këshilltarë ligjorë duke pasur parasysh se ajo ka 19 gjyqtarë. Aktualisht në gjykatë janë në punë 25 këshilltarë dhe 6 priten të plotësohen deri në fund të vitit [21].

Prokurimet

Gjykata e Lartë ka kryer 62 procedura prokurimi përgjatë vitit 2024 [22].

Blerja e karburantit është bërë me një minikontratë me një kompani në vlerën e prokurimit, 6.271.793 lekë. I njëjti proces është edhe në rastin e 'Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh' shërbim me minikontratë në vlerën 1.527.650 lekë.

Në 33 raste zyra e prokurimit në Gjykatën e Lartë ka prokuruar me vlerën e thirrjes dhe në 2 raste ka prokuruar me afro 99% të vlerës së thirrjes qofte në blerje nën vlerën 100.000 lekë, qoftë me prokurim me vlerë të vogël e qoftë me minikontratë.

Në 8 raste janë kryer prokurime me vlerë nga 40-50% të vlerës fillestare të prokurimit, ndër to edhe rikonstrukcion në ndërtesën e gjykatës me afro 3 milionë lekë.

[20] Raporti vjetor i performancës, GJL 2024 f.43

[21],kancelare ne detyrë, takim në GJL , 22 korrik 2025

[22] Regjistri i procedurave të prokurimit GJL, 2024

Transparenca

Ne programin e transparencës në fillim të majit 2025, kur është bërë edhe monitorimi i fundit në funksion të këtij raporti, ishin pasqyruar vetëm prokurimet e kryera dhe jo sipas regjistrit të parashikimit apo realizimit të prokurimeve, një regjistër që përdoret nga të gjitha institucionet publike.

Ndërkaq në dritaren ku publikohen të dhënat e buxhetit ishte publikuar Raporti vjetor i zbatimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2024, por jo raportet 4 mujor dhe 8 mujor të monitorimit.

Gjykata e Lartë është përgjigjur në 33 kërkesa për informacion gjatë vitit 2024. Janë publikuar të gjitha përgjigjet e plota në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve 2024. Koha e përgjigjes ka qenë në të gjitha rastet brenda afateve ligjore të parashikuara nga “Ligji për të drejtën e informimit”.

Ndërsa raporti i GJL thekson se janë trajtuar gjithsej 952 (kërkesa, ankesa apo informacione) një pjesë e konsiderueshme e të cilave (617 kërkesa) është kryer nëpërmjet komunikimit me postën elektronike (e-mail) [23].

Gjykata e Lartë ka krijuar llogari në rrjetet sociale zyrtare Facebook, LinkedIn, Youtube. Gjykata aplikon aksesin përmes programit ‘Gjykata e hapur’ duke u dhënë mundësi qytetarëve ta vizitojnë gjykatën dhe të ndjekin veprimtarinë e saj. Ky akses mundësohet përmes aplikimit të thjeshtë elektronik, duke plotësuar modulet (emër, mbiemër, e-mail dhe përmbajtjen e mesazhit/arsyet e vizitës).

Gjithashtu në faqen e internetit ka një mesatare mujore prej 241,300 vizitorëve unikë dhe 20,375 vizita në ditë.

Gjetje dhe përfundime

Buxheti në dispozicion të Gjykatës së Lartë për 2024 është 392,341 mijë lekë, duke siguruar një trend rritës për këtë gjykatë të paktën që nga viti 2015. Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Gjykatës së Lartë si dhe realizimi i tyre është 386297 mijë lekë, ose 98%, pra një mosrealizim - 6044 mije lekë në raport me planin e parashikuar.

[22] Regjistri i procedurave të prokurimit GJL, 2024

[23] Raporti vjetor i performancës, GJL 2024 f.55

Sasia faktike e 'çështjeve të gjykuara' në Gjykatën e Lartë për vitin 2024 është 7639 ndërsa shpenzimet korente mbi të cilën llogaritet kosto për njësi janë 382.810.000 lekë. Kosto për njësi është 50.000 lekë. Shifra është afro 5 mijë lekë më shumë se viti 2023.

Shpenzime për honorare për anëtarët e KED-it gjatë vitit 2024 janë në shumën 3.485.000 lekë.

Gjykata e Lartë ka kryer 62 procedura prokurimi përgjatë vitit 2024. Në 33 raste zyra e prokurimit në Gjykatën e Lartë ka prokuruar me vlerën e thirrjes dhe në 2 raste ka prokuruar me afro 99% të vlerës së thirrjes qofte në blerje nën vlerën 100.000 lekë, qoftë me prokurim me vlerë të vogël e qoftë me minikontratë.

Në 8 raste janë kryer prokurime me vlerë nga 40-50% të vlerës fillestare të prokurimit.

Në fund të vitit 2024, stoku (BT) i Gjykatës së Lartë ishte 20,058 çështje, duke shënuar një rënie prej 19.8% ose 5,170 çështje më pak, krahasuar me fillimin e vitit kur backlog-u ishte 26,058 çështje.

Parashikohet se brenda 4 viteve Gjykata e Lartë mund të eliminojë backlog-un.

GJL në raportin vjetor 2024 ka kërkuar të shtohet numri i gjykatësve qoftë edhe për një mandat deri në normalizimin e situatës në Gjykatën e Lartë dhe në 2 gjykatat e Apelit.

Backlog në Gjykatën e Lartë filloi të krijohet që në vitin 2013 me afro 2% të çështjeve të mbetura stok për të vijuar me një rritje deri në 5% në vitin 2014 dhe për të vijuar me një rritje më të shpejtë në vitet në vijim. Ka çështje të regjistruara në Gjykatën e Lartë në vitin 2010 që mund të kenë marrë përgjigje në vitin 2023.

Vendimet e mospranimit në dhomë këshillimi përbëjnë 73% të vendimmarrjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë ka marrë lejen për ndërtim ose sheshin e ndërtimit dhe ndërtesa e re do të jetë pjesë e një marrëveshje me kompaninë e ndërtimit nga ana e qeverisë ku i ofrohet tokë publike në këmbim të ambienteve të gjykatës. Gjykata e Lartë ka sot 2362 metër katror sipërfaqe pune ndërkohë që në ndërtesën e re që pritet të përfundojë në vitin 2027 do të ketë afro 7000-8000 metra katror.

Leja është dhënë nga KKRT e Republikës, dhe mbetet vetëm zbardhja e saj nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë. Kompania private ndërtuese e kompleksit që përfshin dy kullat private dhe ndërtesën e re publike të Gjykatës së Lartë, me pesë kate mbi tokë dhe dy kate nëntokë, ka bërë tre prezantime të projektit përpara drejtuesve të Gjykatës së Lartë. Ende nuk dihet vlera në lekë e ndërtesës së re, me sipërfaqe 7,000 m², të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë është përgjigjur në 33 kërkesa për informacion gjatë vitit 2024. Janë publikuar të gjitha përgjigjet e plota në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve 2024. Koha e përgjigjes ka qenë në të gjitha rastet brenda afateve ligjore të parashikuara nga Ligji për të drejtën e informimit".

Ka pasaktësi në raportimin e shifrave të KLGJ për GJL që lidhen me stokun. Pasaktësitë shfaqen kur krahasohen raportet vjetore të KLGJ me ato të Gjykatës së Lartë ose raportet e 2024 me raportet për vitin 2023.

Rekomandimet

Gjykata e Lartë duhet të plotësohet me këshilltarë ligjorë sipas organikës së miratuar për të rritur numrin e çështjeve të gjykuara dhe siguruar ritmin e rënies së stokut dhe mbylljes së tij të plotë në katër vite.

Shtimi i numrit të përgjithshëm të Njesisë së Shërbimit Ligjor (në 2 këshilltarë ligjorë për 1 gjyqtar) do të bëjë të mundur përgatitjen në kohë të sa më shumë çështjeve që duhet të gjykohen nga trupat përkatëse.

Të shqyrtohet propozimi i GJL në raportin vjetor 2024 për të shtuar numrin e gjykatësve qoftë edhe për një mandat deri në normalizimin e situatës në Gjykatën e Lartë dhe në 2 gjykatat e Apelit.

GJL dhe KLGJ duhet të bëjnë transparente marrëveshjen për ndërtimin e godinës së re të gjykatës dhe koston e ndërtimit të saj, pavarësisht se nuk shoqërohet me pagesa nga ana e tyre.

Bibliografia

Legjislacioni dhe Akte Ligjore

- Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitin 2023”, i ndryshuar
- Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
- Udhëzimi Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
- Vendimi nr.1, 21.01.2021 i Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë”

Burime të tjera

- Takim në GJL me Kancelaren në detyrë, përgjegjësen e financës Filloreta Ajdini dhe kordinatoren për Informim, Ida Vodica, 22 korrik 2025

Analizë dokumentesh për institucionin e monitoruar

- Buxheti 2015,2016,2017,...,2022,2023
- Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit 2024, GJL
- Raporti i performancës së GJL, 2024
- Raporti vjetor i GJL, 2023
- Raporti vjetor i GJL, 2022